



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/ Nr. 10326 /2019

Data: 18.11.2019

### PROCESVERBAL I KUVENDIT TË KOMUNËS

Procesverbal nga mbledhja e -X- e Kuvendit të Komunës, mbajtur me datë 31.10.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e Kuvendit të Komunës. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyrytar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), Zaim Bela (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Edon Curri (Drejtor për Administratë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Medina Imishti (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve i Kompanisë N.P.L Pastrimi sh.a), Ilir Kaloshi (Zyrtar i Financave në Kompaninë N.P.L Pastrimi sh.a), Bashkim Sopa (Zyrtar për Informim), Përfaqësuesit e OSB-së, Nusret Shiti (Kordinatorë i Këshillave të Fshatrave). Kryesuesi i kuvendit pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të kuvendit, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i kuvendit të komunës.

#### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2019.
3. Miratimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.
4. Shqyrtimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.
5. Miratimi i planit finanziarë i N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i informatës për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin finanziar për nëntëmujorin e N.P.L Pastrimi sh.a.
8. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës keni edhe dy materiale shtesë njëri është shqyrtimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit, kurse materiali i dytë shtesë është propozim vendimi për themelimin e komisionit për shqyrtimin e arsimit në shkollat rurale në komunën e Hanit të Elezit. Lidhur me pikat e rendit të punës hapi diskutimin,

**Florim Shkreta** thekson:- unë propozoj që propozim vendimin i cili tash u shpërndanë te anëtarët e kuvendit të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të kuvendit të komunës

**Kryesuesi** thekson:- për këtë çështje diskutuanë mbledhje të kaluar dhe u dakorduan që në këtë mbledhje me formuar komisionin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- këtë çështje e kemi diskutuar edhe në Komitet për Politik e Financa dhe sot ne mund ta formojmë vetëm grupin ndërsa punën në të ardhmen mund ta kryen. Unë jam pro që me hyjë si pikë e rendit të punës dhe anëtarët e kuvendit mund të diskutojnë.

**Menduh Vlashi** thekson:- unë mendoj që më mirë është me formuar komisionin por ju mund të propozoni edhe ndonjë person që mund të jep kontribut për këtë çështje.

**Akif Shkreta** thekson:- un mendoj që duhet të themelohet komisioni në këtë mbledhje , mirëpo drejtori mund ta bëjë paraprakisht një elaborim për këtë çështje. Është mirë që komisioni ta ketë një rregullore për rolin dhe detyrat e grupit.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për materialin shtesë , nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri. Në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA RENDI I PUNËS

**Procedojmë me këtë rend të punës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2019.
3. Miratimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.
4. Shqyrtimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.
5. Miratimi i planit finansiarë i N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2020.
6. Shqyrtimi i informatës për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML.
7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin finansiar për nëntëmujorin e N.P.L Pastrimi sh.a.
8. Shqyrtimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.
9. Propozim vendimi për themelimin e komisionit për shqyrtimin e arsimit në shkollat rurale në komunën e Hanit të Elezit.
10. Të ndryshme.

#### 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedhë në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

#### 2. Miratimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Shtator 2019.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Shabi Rexhallari** thekson:- nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-shtator 2019 është në shumë prej 1,785,303.16 € apo 55.69 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,105,197.48 € apo 74.25 %, për mallra dhe shërbime 169,648.58 € apo 64.72 %, për shpenzime komunale 33,183.68 € apo 61.00 %, për subvencione dhe transfere 55,783.80 € apo 84.21 % dhe për shpenzime kapitale 421,489.62 € apo 31.70%. Të hyrat vetanake për këtë periudhe nëntëmujore 2019 janë realizuar në shumë prej 241,740.21 € apo për 15,206.13 Euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Shpenzimi për këtë periudhë nëntëmujore 2019 është realizuar në shumë prej 1,784,803.08 Euro apo 281,455.90 Euro më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Akif Shkreta** thekson:- sa i përket subvencioneve me çka është ndihmuar bujqësia. Të hyrat vetanke kanë rritje prej 6.71 %, kërkoj informacion sa i përket rritjes së të hyrave vetanake. Shpenzimet buxhetore 55.69% për periudhën Janar-Shtator, ndërsa deri në fund të vitit i kemi edhe dy muaj dhe a kemi një shpërputhje. Kërkoj sqarim për bartjen e mjeteve të paspenzuara nga viti 2018 sepse kemi alokime të shumta.

**Mefail Suma** thekson:- totali i shpenzimeve që është përqindja 50.14 % dhe ndoshta ka bortxhe komuna që nuk i ka kryer ende, mirëpo nëse është kjo përqindje e shpenzimeve si do të mund të shpenzohen këto mjete për shkak se kemi edhe dy muaj deri në fund të vitit.

**Sabedin Hasallari** thekson:- te mallrat dhe shërbimet kemi një ngritje të madhe dhe kërkoj sqarim për këtë çështje. Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare jashtë vendit dhe transporti i nxënësve po të krahasohet me vitin 2018 është një ngritje qind për qind. Ngritje kemi edhe të furnizimi me ushqim dhe pije. Kërkoj sqarim për kodin mirëmbajtja e ndërtesave sepse po të krahasohet me vitin 2018 kemi një ngritje në shumë prej 33000 €.

**Teuta Shkreta** thekson:- cilat kompani i kemi të kontraktuara për regjistrim dhe mirëmbajtje të automjeteve?

**Mehmet Ballazhi** thekson:- kërkoj sqarim për shpenzimet-vendimet e gjykatave në shumë prej 4,611.65 €. Shpenzimet e drekave zyrtare në krahasim me vitin 2018 është një vlerë shumë e madhe. Mirëmbajtja e rrugëve lokale në shumë prej 10,458.50 € po të krahasohet në vitin e kaluar kemi një shumë më të lartë prej 2684.60 € më shumë. Botimet e publikimeve në shumë prej 2,603.95 €, kurse në vitin 2018 janë në shumë prej 480.00€. A ka përputhshmëri me planifikimet buxhetore për vitin 2019 në krahasim me shpenzimet buxhetore që janë bërë?

**Shabi Rexhallari** thekson:- deri në muajin shtator subvencionet i kemi shpenzuar në shumë prej 6406.80 € për grurë, serra tunel, lule shtrydhe dhe pula vojëse. Është bërë marrëveshje me laboratorin Lab që komuna ka participuar mbi 4000 € për sistemin pik pik për luleshtrydhe. Sa i përket rritjes së të hyrave e kemi raportin sipas drejtive që më tepër ka ndikuar te shërbimet publike të hyrat nga reklamimet dhe publikimet, te zhvillimi ekonomik, në urbanizëm, ndërsa te drejtoria e financave kemi një zbritje në ato lloje që i ka drejtoria. Te shëndetësia kemi një zbritje te participimi dhe nga gjobat që i bien policia kemi një zbritje. Shpenzimi janar-shtator është 55.69 % dhe të gjitha kontrata për investimet kapitale kanë përfunduar dhe janë në ekzekutim të punimeve të investimeve kapitale. Alokimet e shumta ndodhin me vendime të kuvendorit dhe me vendime të ministrive dhe mjetet të cilat kanë qenë nëse nuk shpenzohen duhet të barten me vendim të kuvendorit të komunës të cilat nuk ishin të shpenzuara për shkak të punimeve të cilat nuk i kanë kryer operatoret të cilat ishin të hyra të viti të kaluar dhe mjetet financiare të cilat ishin të dedikuar për përruin e fshatit Seçishtë janë bartur për shkak se kompania "Sharrcem" e ka financuar. Grandi nga Qeveria Japoneze e kemi fituar për blerjen e një kamioni për mbeturina. Përqindja 50.14 % ka të bëjë me periudhën janar-shtator të vitit 2018. Sa i përket transportit të nxënësve shpenzimi është më i madh për shkak se janë lëshuar disa linja prej Rezhancës në Gorancë, prej te Laçt në Han të Elezit dhe transporti i nxënësve në Kaçanik në shkollat profesionale. Çështja e mëditjeve jashtë vendit me ligj është e përcaktuar dhe një pjesë e shpenzimeve janë të viti të kaluar, kurse pjesa tjetër është për takimet që i kanë pasur në këtë vit zyrtarët. Mirëmbajtja e ndërtesave ka të bëjë me dëmtimet e nyjeve sanitare, elektrifikim. Te sigurimi i automjeteve kompania e cila ka fituar është "Sib Kos" dhe shuma më e madhe është për shkak të regjistrimit të veturave të reja. Shpenzimet e gjykatave ka të bëjë me pagesën e tri pagave për tre arsimtarët e pensionuar. Rritja për drekat zyrtare është për shkak se në këtë vit ka qenë 20 vjetori jubilarë. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugëve kemi pasur tri marrëveshje me kompanitë e që njëra është për mirëmbajtjen verore dhe dimërore, njëra është për zhbllokin e kanalizimeve dhe disa pusetave të cilat janë rregulluar. Sa i përket botimeve dhe publikimeve ka të bëjë me botimin e vjetarit për vitin 2018 dhe tjetra është për publikimin e aktiviteteve komunale, botimi i revistës shkolllore për shkollën fillore "Kështjella e Diturisë"

**Akif Shkreta** thekson:- sa është subvencionuar për grurë?

**Zaim Bela** thekson:- sa i përket subvencionimit të grurit në fshatin Krivenik ishin dy hektarë dhe ata janë kositur për shkak se nuk ka pasur kombajë që do të thotë janë subvencionuar dy hektarë dhe atë në shumë prej 130 € për një hektarë .

**Teuta Shkreta** thekson:- rruga që është prej te mbikalimi në hekurudha e cila shkon në drejtës së Seçishtës nuk është e ndriçuar dhe mendoj që është një rrugë shumë e frekuentuar . Kjo rrugë është shumë urgjente që të ndriçohet për shkak se fëmijët udhëtojnë për në shkollë.

**Refet Kalisi** thekson:- është e vërtetë që është rrugë e frekuentuar shumë por në biseda që kemi pasur me hekurudhën kanë potencuar që do të investojnë dhe për atë nuk është investuar por besoj që në vitin e ardhshëm do t' i shikojmë mundësitet buxhetore me rregulluar.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 11 për 3 abstenim.

#### U MIRATUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR –SHTATOR 2019

#### 3. Miratimi i propozim ndryshimeve për rregulloren për transparencë.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Edon Curri** thekson:- rregullorja i ka kaluar të gjitha fazat por pasi Ligji për Qasje Publike ka pasur ndryshime, kemi rekomandim nga departamenti ligjor i MAPL-së që të harmonizojmë rregulloren me nenin 20 të këtij Ligji.

**Akif Shkreta** thekson:- të gjitha rregulloret që kalojnë në kuend kisha kërkuar që të hartohen nga një komision profesional dhe të përcillen në kuend.

**Edon Curri** thekson:- komuna e ka komisionin për hartimin e akteve i cili është i përbërë nga zyrtarë komunal.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte 13 për 1 kundër.

#### U MIRATUA PROPOZIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR TRANSPARENCE

#### 4. Shqyrtimi i propozim rregullores për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Medina Imishti** thekson:- vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës e ka miratuar Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, e koalicioni i organizatave e ka hartuar këtë rregullore për të gjitha komunat. Materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- në fillim të fjalisë si kryefjalë përdoret kuveni i komunës dhe mbështetja ka filluar prej kuvenit të komunës por ky term është mirë që të jetë në fund që kuveni i komunës mori vendim. Në preambulë shënuar se me datë ndoshta ka aluduar në datën e sotme, aprovon rregulloren për realizimin e të drejtave të fëmijëve përmes sistemit qeverisës komunal miqësorë për fëmijët, e miraton këtë. Me që miraton këtë rregullore nuk ka nevojë që me u përmendur datën dhe ta përdorë njërin term aprovon ose miraton këtë rregullore. Është shënuar viti 2019 aprovon por të fshihet dhe në fund të jetë këtë rregullore. Te dispozitat e përgjithshme neni 1 pika 2 dispozitat e kësaj rregullore zbatohen për të gjithë fëmijët e veçanërisht për fëmijët më të përjashtuar dhe më të cenuar . Kërkoi që fjalia në mes dy presjeve veçanërisht për fëmijët më të përjashtuar dhe më të cenuar të fshihet. Neni 3 termi fëmijë është përmendur edhe në njëjës edhe në shumës dhe është mirë që të përmendet vetëm me njërin numër , mirëpo më mirë do të ishte që të përmendet në numrin shumës sepse te neni katër e kemi në shumës fëmijët. Neni 5 pika 3.11 është shënuar bashkësitetë lokale dhe me që në komunën tonë nuk organizohen nëpërmjet bashkësive lokale do të ishte më mirë të jetë këshillat e qytetit dhe fshatrave. Kjo rregullore krijon shpenzime sepse për me u kujdesur për fëmijët duhet me shpenzuar dhe a do të ndanë buxhet komuna për këtë çështje? Sipas kësaj rregullore parashihet që të punësohet një koordinatorë për të drejtat e fëmijëve.

**Medina Imishti** thekson:- në momentin që kryetari e formon mekanizmin vendosë edhe për çështjen e buxhetit. Sa i përket pranimit të koordinatorit e kemi me detyrë shtesë një zyrtarë për këtë çështje

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim rregulloren; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### **U VOTUA RREGULLORJA PËR REALIZIMIN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE PËRMES SISTEMIT QEVERISËS KOMUNAL MIQËSORË PËR FËMIJË QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

##### **5. Miratimi i planit finansiarë i N.P.L Pastrimi sh.a për vitin 2020.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Ilir Kaloshi** thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- punëtorët të cilët punojnë në kompaninë “Pastrimi” nuk vendosin maska mbrojtëse gjatë zbrazjes së kontinierëve.

**Akif Shkreta** thekson:- shpenzimet janë të specifikuara por nuk janë të specifikuara sa paga janë . Cilat zona janë të pa mbuluara dhe çka do të bëjë kompania me personat të cilët nuk kanë kontrata? A ka ndonjë plan për lirim nga pagesa për kategoritë e caktuara?

**Mefail Suma** thekson:- kjo kompani a ka rregullore përmjet punëtorëve.

**Florim Shkreta** thekson:- vërejtje kam për kompaninë në fjalë sepse ende nuk ka marr ndonjë veprim ndaj personave të cilët nuk kanë nënshkruar kontratë dhe iu bartën mbeturinat, kurse pjesës tjetër nuk iu bartën. Kërkoi informacion se ku hedhen ato mbeturina? Nuk kemi ndonjë përgjigje për pyetjen që e ka parashtruar këshilltari z.Sabedin Hasallari për personat të cilët janë dërguar në përmbarues. Potencoitet se do ta bëjnë pastrimin e rrugëve gjatë sezonës së verës dhe dimrit por mendoj që nuk kanë kapacitet për me i kryer këto punë sepse ka fshatra që ende nuk e ka ushtruar veprimtarinë kompania për shkak se ka lagje në fshatin Seçishtë që nuk e pastron. Ende nuk dihet se cila kategori ka me u liruar nga pagesa e jo të shkohet në atë mënyrë që dikush ndëshkohet e dikush nuk ndëshkohet dhe mendoj që nuk është në rregull.

**Sabedin Hasallari** thekson:- të hyrat e planifikuara dhe shpenzimet e planifikuara për vitin 2020 i keni planifikuar të barabarta por mendoj që planifikimi të bëhet më mirë që të hyrat të janë më të mëdha dhe të krijohen kushte më të mira në këtë ndërmarrje. Unë propozoj që kompania të bënë ndarjen e mbeturinave dhe do të kishte një fitim të mirë.

**Ilir Kaloshi** thekson:- rregullore kompania përmjet punëtorëve nuk ka, ndërsa masa mbrojtëse ka dhe janë dorëzat dhe maska por është e drejtë e punëtorit se a i përdorë, kurse kompania e ka për detyrë me ua siguruar. Unë mendoj që janë qind për qind zonat e mbuluar nga kompania edhe bartja e mbeturinave por edhe pastrimi i rrugëve. Për çështjen e personave të cilët janë dërguar në përmbarues kompania nuk mund të bëjë lehtësime sepse është çështje përmbaruesit. Planifikimet dhe shpenzimet duhet të janë barbarë kurse klasifikimi i mbeturinave nuk mund të bëhet por edhe askund në Kosovë nuk bëhet klasifikimi i mbeturinave .

**Mefail Suma** thekson:- rregullorja përmjet punëtorit është e nevojshme për shkak se mund të dënoheni nga inspektori i punës .

**Florim Shkreta** thekson:- a mbulohet në fshatin Seçishtë Lagjja mbi Xhaminë që është dhe a kanë të gjithë kontrata për shkak se nuk mund qytetari ta bartë kontinierët një kilometër për me u sjellë në asfalt. Banorët ishin të interesuar me lidhë kontratë por ju keni deklaruar se nuk mundeni me dalë atje lartë me u marr kontinierët e mbeturinave. Potencojnë që i kanë eliminuar gjitha deponitë ilegale por nuk është e vërtetë sepse vetëm i kanë shtuar dhe mbetjet e "Sharcemit" në fshatin Krivenik i kanë djegur dhe e tërë bota rekomandon që mos me dhezur zjarre se ndotet ambientit kurse zyrtarët e ligjit e thejnë ligjin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- te planifikimi i buxhetit është mirë të shprehet në euro. Sa i përket masave mbrojtëse është ligji që e parashek mbrojtjen e punëtorit nga rreziku dhe masat mbrojtëse duhet me i përdorë punëtorët sepse është e paraparë me Ligj. U theksua më lartë që ka qytetarë që ende nuk ka nënshkruar kontratë por ku hedhen ata mbeturina është mirë të dihet

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PLANI FINACIARË I NPL PASTRIMI SHA PËR VITIN 2020

#### 6. Shqyrtimi i informatës për raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 në SHFMU dhe SHML.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- materialin për këtë pikë të rendit të punës e keni pranuar me kohë dhe nëse keni edhe ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

**Mefail Suma** thekson:- për stafin teknik dhe për punët të cilët janë kryer rrëth fasadimit nëpër shkolla nuk i ka sjellë në këtë raport dhe është mirë të na informoni për këto çështje. Suksesi te klasat e para është me sukses katër e më shumë dhe pastaj në klasën e dytë tretë dhe të katërt vjen duke rënë suksesi dhe a është bërë ndonjë analizë për këtë çështje?

**Akif Shkreta** thekson:- unë mendoj që ky raport ka vlejtur deri në vitin 2015, ndërsa pas vitit 2015 kur arsimi është pjesë e kurikulës së re duhet të jetë një informatë sepse nuk është shumë ndoshta e rendësishme që të kemi informacion për mungesat e arsyeshme apo të pa arsyeshme të nxënësve. Më e rendësishme është që pjesë e raportit të jetë vlerësimi për shkallë kurikilare se shihet qartë se sa janë zhvilluar gjashtë kompetencat sipas kurikulës së re. Pjesë e raportit në formë pëershkruese duhet të jetë edhe niveli i pastërtisë për shkak se inspektorati sanitari vazhdimesh i monitoron shkollat. Është mirë ta kemi edhe raportin e inspektoratit të arsimit i cili vazhdimesh i monitoron gjendjen e shkollave në komunën tonë.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- si pikë të rendit të punës e kemi raportin e DKA-së mbi suksesin e arritur për fundin e vitit shkollor 2018/2019 dhe nëse ishte dashur të hyjë edhe diçka tjetër ashtu siç potencoij ish dashur edhe rapporti me ndryshuar si raport.

**Akif Shkreta** thekson:- në raport janë paraqitur orët e humbura dhe orët e mbajtura është paraqitur raport mbi suksesin por ndoshta është më i përgjithshëm se suksesi. Një raport i gjendjes nëpër shkolla të komunës sonë është i përgjithshëm. Nëse potencohet se është rapporti suksesit dhe nëse nuk është rezultati për shkallë faktikisht nuk është në rregull.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- për atë potencova që nëse kërkohet rapport mbi gjendjen në arsim duhet të ndryshohet titulli i rapportit dhe në këtë mbledhje jemi duke diskutuar për rapportin e suksesit.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- është vetëm një nxënës i cili e ka braktisur shkollen dhe i cilës gjini është dhe a është ndërmarrur diçka për këtë çështje?

**Florim Shkreta** thekson:- te suksesi i nxënësve vërehet që nuk ka sukses në arsim duke u nisur që drejtorët e shkollave afër 13 vite është drejtorë me një shkollë dhe nuk ndërrrohet që do të thotë dihet se çfarë suksesi mundet me pasur. Drejtori për Arsim a është në dieni që me datë 28.10.2019 që në klasën XII<sup>1</sup> është përdorur substancë narkotike?

**Isni Bushi** thekson:- të gjithë e dimë që me ndërrimin e sezonës edhe orët janë nga 45 minuta dhe propozoj që orët me u kthyer ashtu siç ishin për shkak të nxënësve të pasdites se orët kur përfundojnë bëhet errësirë. Nëse janë mundësitë kjo me u bërë sidomos gjatë sezonës dimërore deri në fund të muajit mars.

**Kryesuesi** thekson:- në komunën e Ferizajt në moment që është ndërruar ora ka filluar përsëri që orët me u mbajtur nga 40 minuta dhe ju në Han të Elezit po e shihni që për fëmijët është shumë problem. Është mirë me vepruar si komunat tjera sepse me ndërrimin e orës përsëri orët janë t'i mbajtur nga 40 minuta. A mendoni si drejtori me ndërmarr diçka apo do të vazhdoni në këtë formë?

**Menduh Vlashi** thekson:- sa i përket punëve teknike e keni pasur në informatën e fillimit të vitit shkollorë në muajin shtator. Drejtorët e shkollave na raportojnë për suksesin e shkollave por edhe për orët e humbura sepse edhe orët e humbura ndikojnë në suksesin e nxënësve. Sa i përket nivelit të pastërtisë unë duhet me i dërguar inspektorët në mënyrë që me pa se në çfarë gjendje është shkolla, kurse drejtorët për çdo javë vijnë në takime dhe raportojnë për gjendjen se si është në shkollë dhe nuk kam pas ndonjë arsy shumë të madhe se kemi gjendjen keç për me raportuar në kuvend. Raporti i inspektoratit të arsimit nuk del në kuvend sepse ato raporte dërgohen te drejtori i shkollës. Ne kemi raportin e suksesit për diskutim dhe duhet ta analizojmë se a kemi arritur sukses apo jo. Sa i përket nxënësve të klasëve të ulëta që janë notuar me notë më të lartë ata janë mësues klase dhe i vlerësojnë me nota më të larta dhe rritja e fëmijëve në adoleshencë në klasë të shtatë tetë vjen tu rënë suksesi. U potencua nga këshilltarët që nuk ka rezultate por nuk mund të themi që nuk ka rezultate sepse e kemi inspektoratin dhe drejtorët e shkollave për me i vlerësuar. Çështja e ndërrimit të drejtorëve është e përcaktuar me ligj për vazhdimin e mandatit të drejtorit për performancë të mirë i vazhdohet kontrata pa konkurs. Ne nuk e dimë a është përdorur narkotikë por dyshime ka pasur dhe janë marr masa me një herë atë ditë dhe sipas deklaratave të shumicës së nxënësve një nxënës është përjashtuar por ne nuk jemi faktorë që mund të themi që ka përdorur narkotikë. Sa i përket shkurtimit të orëve duhet të diskutohet me këshillin e prindërve, me arsimtarët dhe drejtorin e shkollës. Unë i zbatojë urdhëresat prej Ministrisë së Arsimit dhe kam dëgjuar që disa komuna nuk janë te respektuar.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## 7. Shqyrtimi i informatës mbi raportin financiar për nëntë mujorë e N.P.L Pastrimi sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Kujtim Dernjani** thekson:- materialin e kemi përcjell me kohë dhe nuk keni diçka të veçantë përvëç materialit të cilin e kemi dërguar.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të paraparë sipas agjendës.

## **8. Shqyrtimi i propozim ndryshimit të rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani** thekson:- me udhëzimin e ri është ndryshuar forma e bashkëpunimit të komunës me fshatrat dhe lokaliteteve të ndryshme të cilat bashkëpunojnë me komunën. Në bazë të numrit të banorëve komuna e Hanit të Elezit bien në kategorinë e komunave të cilat i kanë 10,000 banorë dhe për këtë numër të banorëve udhëzimi administrativë e parasheh që komuna t'i këtë katër këshilla të fshatrave. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- tabela e parë që është shënuar lista e fshatrave dhe vendbanimeve të komunës nuk është Vërtomica dhe te fshati Dermjakë është mirë të shënohet zyrtarisht si shkruhet. Si janë përcaktuar këto këshilla, a në bazë të zonave kadastrale apo në çfarë forme për shkak se te Lagja e Re do të jetë problemi më i madh? Cila është vija përcaktuese e Lagjes së Re?

**Mallzum Qajani** thekson:- ne e kemi parashtruar këtë propozim por secila lagje mund të përcaktohet se me kënd i konvenon me shkuar mirëpo ne nuk mund ta kalojmë numrin më shumë se katër këshilla. Propozim rregulloren do ta diskutojmë edhe në diskutim publik që do të marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e këshillave të fshatrave. E kemi pak vështirë për shkak se këto vendbanime janë krijuar më herët dhe e kemi problem me përcaktuar që deri por ne e kemi një zonë urbane që mund të themi që 90 % e Lagjes së Re i bien që është zonë urbane e Hanit të Elezit. Komuna e Hanit të Elezi nuk ka kufij zyrtarë që mund të themi deri në këtë vend i bien Lagja e Re por kufi zyrtar komuna i ka zonat kadastrale.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **U VOTUA PROPOZIM NDRYSHIMI I RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRAT, VENDBANIMET DHE LAGJET RUBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR DEBAT PUBLIK**

## **9. Propozim vendimi për themelimin e komisionit për shqyrtimin e arsimit në shkollat rurale në komunën e Hanit të Elezit.**

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi** thekson:- vitin e kaluar në bashkëbisedim me prindërit e fshatit Laç dhe Rezhancë kemi arritur një pajtim që fëmijët e tyre t'i transportojmë për shkak ngritjes së cilësisë dhe prindërit e këtyre fshatrave janë të kënaqur. Në bashkëbisedim me prindërit e fshatit Krivenik nuk kemi mundur me i bindur, mirëpo problem kemi edhe me fshatin Seçishtë që numri i nxënësve ka rënë shumë dhe nëse respektohet ligji duhet të bëhet mësimi i kombinuar por në bashkëpunim me kryetarin e kemi lënë që edhe në këtë vit dhe me formuar një komision për këtë çështje. Emrat i keni në propozim vendim dhe mund të propozoni edhe anëtarë të tjerë të komisionit.

**Nora Xhoni** thekson:- propozoj që pjesë e këtij komisioni të jetë kryetari i këshillit të fshatit Krivenik.

**Akif Shkreta** thekson:- propozoj që pjesë e këtij komisioni të jetë kryetari i sindikatës komunale të arsimit z.Basri Dernjani.

**Florim Shkreta** thekson:-në fshatin Rezhancë dhe në fshatin Laç i ka mbyllur shkollat pa e sjell çështjen në kuwend, kurse për fshatin Seçishtë çështjen e sjell në kuwend.

**Mallzum Qajani** thekson:- politikat tona si komunë në lokalitete ku nuk ka pasur nxënës jemi munduar të bisedojmë me prindërit që për ata fëmijë fëmijët të organizojmë transport në shkollën më të afërt. Rasti ishte me fshatin Rezhancë dhe me fshatin Laç që si komunë kemi hasur në mirëkuptim. Kemi biseduar me banorët e fshatit Krivenik dhe Seçishtë por megjithatë edhe pse jemi munduar që të mobilizohemi që vitin shkollorë që kemi filluar në këtë vit që të rritet numri i nxënësve por nuk kemi rezultate që ka lëvizur në këtë drejtim. Ne si komunë nuk duam që të marrim vendim sepse janë personat që përfaqësojnë këto fshatra dhe janë personat që janë përkatës për arsimin ne të bisedohet dhe t'i rekomandojnë kuvendit të komunës dhe pastaj kuvendi vendosë. Interesi i këtyre fëmijëve dhe i këtyre shkollave është që me ardhur në Han të Elezit sepse as futboll nuk mund të lozin bashkë, as nuk ka shoqërizim apo elemente të tjera që realisht flasim unë mendoj që në interes të fëmijëve që ata të vijnë në Han të Elezit.

**Mefail Suma** thekson:- çka bëhet me objektet shkollore dhe me personelin arsimorë?

**Menduh Vlashi** thekson:- nuk do të del punëtorë nga puna për shkak se në shkollën fillore i kemi nga 34 nxënës dhe i ndajmë dhe bëhet një klasë, ndërsa nëse nuk mundemi mi bërë klasë mbajmë mësimdhënës mbështetës.

**Florim Shkreta** thekson:- unë mendoj që duhet të shterren të gjitha mundësitë dhe nuk është mirë që me i nxitur prindërit e fshatit Krivenik që fëmijët e tyre me i dërguar në Han të Elezit sepse fëmijët e tyre mund t'i dërgojnë në shkollën e Seçishtës. Më mirë është që mos të mbylljet shkolla e Seçishtë sepse ndoshta dikujt ia imponojmë që fëmijën me dërguar atje në shkollë dhe ndoshta e shkelim rregulloren por rregullore jemi duke shkelur edhe në shkollën fillore në Han të Elezit sepse 40 nxënës mësojnë me një klasë që mendoj që është e tepërt.

**Nora Xhoni** thekson:- në Lagje me sa jam i njofuar janë vetë katër fëmijë të cilët janë në klasën e parë dhe nëse i dërgojmë atë fëmijë në fshatin Seçishtë do të bëhen nëntë që do të thotë që me i kombinuar nuk munden me mbërrri numrin në 14 nxënës.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U MIRATUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ARSIMIT NË SHKOLLAT RURALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

##### 10. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mefail Suma** thekson:- është mirë që të barten nxënësit e fshatit Dimcë gjatë sezonës dimërore për shkak se pjesa e përroit është shumë e ftohët gjatë sezonës dimërore. Këtë kërkesë e parashtroj për shkak se ka fëmijë para shkollorë dhe është edhe rrezik prej qenve endacak.

**Akif Shkreta** thekson:- është mirë që të bisedohet në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi për shkak se po ka tejkalin të shpejtësisë nëpër qytet dhe nëpër fshatra. Kërkoj informacion për çështjen e pagave jubilare.

**Sabrije Krasniçi** thekson:- kërkesë kam parashtruar që prej te kufiri e deri te binarët e trenit në atë rrugë të vendosen kamera sepse është rrezik edhe për fëmijët për shkak se vetrurat po i vozisin me shpejtësi të madhe. Banorët e lagjes nën hekurudhë kanë kërkesë që rruga prej Lagje Reçi që shkon në drejtim të kufirit që është përreth hekurudhës të shtrohet me kubëza betoni. Është një nxënës të cilin shumë e dërgojnë nëpër shkolla e transferojnë dhe a nuk është e mundur që me gjetur një mënyrë që me kaluar sa më shpejtë shkollën ai.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në vendin që ndodhi fatkeqësia është mirë që të vendosen masa mbrojtëse edhe anën e poshtme por edhe në anën e epërme. Duhet të merret seriozisht kjo çështje.

**Florim Shkreta** thekson:- përgjigjet për pyetjet që kam parashtruar nuk më janë dërguar. Rrugët të cilat shtrohen me kubëza në çfarë forme bazohen për shkak se janë t'i shtruar edhe oborret e personave privat. Me mjetet financiare që paguaj tatim nuk keni nevojë ju me bërë mirë. A bazoni me ndonjë rregullore apo me taksapaguesit e qytetarëve përfiton si pushtet?

**Hanumshahe Dibrani** thekson:- në mbledhje të komitetit për komunitete kemi pasur ankesë te rruga Kushtrimi i Lirisë afér lagjes së Çupve në fshatin Paldenicë për shkak se është mbyllur shakti i përroit i cili kalon në atë pjesë.

**Mallzum Qajani** thekson:- do të ishte mirë që secilit fëmijë me ia siguruar transportin për në shkollë dhe do të isha shumë i kënaqur nëse jam pjesë e kësaj komuna që t'i mbërrimë këto standarde që secilin fëmijë ta marrim para dere për me dërguar në shkollë dhe prej shkollës ta dërgojmë para dere, mirëpo ne e kryejmë obligimin sipas ligjt për me i bartur nxënësit dhe Dimca nuk i përbushë kriteret e largësisë sipas Ligjit. Çështja e qenëve endacak është problem që e preokupon komunën e Hanit të Elezit qe disa vite por nuk kemi zgjidhje për shkak të çështjes së ligjit. Çështjen e tejkalimit të shpejtësisë e diskutojmë shpesh në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi por është problem me pasur në tërë lokalitetin prezencë fizike të policisë. Për pagat jubilare e kemi biseduar si komuna se për të gjitha ata të cila i parashev ligji do t'i paguajmë. Shtimi me kubëza betoni i rrugës afér ferovisë është një segment i shkurtë për komunën dhe nëse nuk ka ndonjë problem me pronat mund ta shtrojmë me kubëza betoni. Sa i përket mbrojtëseve të rrugës kemi biseduar me Ministrinë e Infrastrukturës por pika që përcaktohet nuk ka vend për me i vendosur por jemi duke menduar për atë çështje por si do të zgjidhet teknikisht nuk e di sepse ende nuk kemi vendosë. Nëse një familje për shkak të ndarjes duan me bërë një rrugë publike dhe nëse shtrohet me kubëza janë të obliguar me bërë rrugën publike. Sa i përket përroit që u përmendë është paraqitur si problem edhe në dëgjimet publike me qytetarët por do të shikojmë mundësitë se si do të zgjidhen.

**Menduh Vlashi** thekson:- të gjitha mundësitë ia kemi dhënë atij nxënësi ka punuar pedagogu me të dhe unë si drejtor i drejtorisë por nuk ka pasur sukses dhe tash është transferuar në shkollën e fshatit Gorancë dhe shpresoj që do të përmirësohet.

**Kryesuesi** thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen e kuvendit të komunës. Ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 13:54

Procesmbajtësi

Ayni Bushi

